



VENDIM

Nr. 26 Datë 21.03.2014

MBI

**KËRKESËN E NJË PREJ AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
“PROJEKSION ENERGJI” SH.A PËR HEQJEN E LIÇENSËS DHE
ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES MIDIS PALËVE**

Në mbështetje të neneve 8 gërma “d” dhe 9, të Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar dhe nenit 36 paragrafi i dyte i Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 18 gërma “b” i Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.03.2014, mbasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s, lidhur me kërkesën e një prej aksionerëve të shoqërisë “Projeksion Energji”sh.a, për heqjen e licensës nr. 40 Seria PV06P, për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et: “Çarshovë”, “Treska 1” dhe “Rehovë”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Projeksion Energji” sh.a me vendimin nr. 76 date 07.11.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është pajisur me liçensën e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet: “Çarshovë”, “Treska 1” dhe “Rehovë”.
- Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin Nr. 47 date 18.04.2008, ka miratuar kërkesën e Shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a për ndryshimin e liçensës nr. 40 Seria PV06P, për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet : “Çarshovë”, “Treska 1” dhe “Rehovë”.
- Aktualisht shoqëria është pa status ligjor nga pamundësia numerike e aksionerëve për të marre vendim. Hec- Çarshovë ka kaluar në pronësi të trashëgimtarëve, të ish-pronareve që e kanë privatizuar. Hec-et Rehovë dhe Treska-1, siç del dhe nga monitorimi i bere nga grupi i ERE-s dhe nga akuzat e ndërsjellta të aksionerëve janë të dëmtuar nga vete poseduesit, marrëdhëniet e shoqërisë me institucionet që operojnë janë të provokuara nga akuzat e aksionerëve, dhe marrëdhëniet konfliktuale ndërmjet tyre e kanë çuar shoqërinë për prishje në gjykatë.

- Bazuar ne Ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007, “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” shoqeria “Projeksion Energji” sh.a nga te dhenat e ekstrakteve te QKR-së rezulton e prishur dhe çregjistrimi i saj do të behet ne baze te nenit 48-51 me vendim gjyqësor te paankimueshëm për ndarjen e kapitalit. (me vërtetimin date 18.02.2013 te lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, prishja e kësaj shoqërie është objekt gjykimi).
- Kërkesa për heqje licëse vjen nga njeri nga aksionerët e shoqërisë dhe jo nga forumet drejtuese te shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a.
- Çështjet ku bazohet kërkesa për heqje licence janë objekt konflikti gjyqësor ndërmjet aksionerëve të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a siç dëshmohet me Vërtetimin e datës 18.02.2013 te lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane Dhoma Civile, rezulton se pranë kësaj Gjykate është regjistruar çështja civile me nr. 624 Akti, date depozitimi 08.03.2012 dhe date regjistrimi 12.03.2012. Palët ndërgjyqëse në këtë proces rezultojnë të jenë: paditës z. Sokol Riska, i paditur z. Anastas Riska dhe pale e trete QKR. Objekti i gjykimit është: Prishja e Shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a, ndarje e asetëve ne përpjesëtim me zotërimin e aksioneve te secili. Vlen të theksohet fakti se kjo çështje është ende ne gjykim.
- Në bazë të nenit 8 pika 2, germa “d” te Ligjit nr. 9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, *ERE ka kompetence vetëm te zgjidhë mosmarrëveshjet midis te licensuarve*. Çdo mosmarrëveshje e lindur midis aksionerëve te shoqërive te licensuara duhet te zgjidhet ne gjykate. Po ashtu Kodi i Proçedurës Civile, në nenin 36 paragrafi i dyte shprehet qartë se: *“Asnjë institucion tjetër nuk ka te drejte te pranoje për shqyrtim nje mosmarrëveshje civile qe është duke u gjykuar nga gjykata*. Dhe Kodi i Proçedurës Administrative në nenin 18 germa “b” përcakton se: *“Në mënyrë që të mbrohen të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave privatë, veprimtaria administrative i nënshtrohet: kontrollit nga gjykatat në përputhje me dispozitat e Kodit të Proçedurës Civile”*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

Vendosi:

1. Mosfillimin e procedurave për heqjen e Licënsës së shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a.

2. Shpalljen e moskompetencës së ERE-s për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve midis aksionerëve të Projekcion Energji sh.a.
3. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.